Република Северна Македонија
ОПШТИНА ЖЕЛИНО
ЖЕЛИНО

Republika e Maqedonisë së Veriut
KOMUNA E ZHELINËS
ZHELINË

PROGRAM

(Për rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës shkollore, aktiviteteve shkollore dhe jashta mësimore në shkollat fillore të komunës së Zhelinës për vitin 2022)

Përgatiti: **Saubi Avziu**

Lazim Idrizi

Zhelinë

Dhjetor, *2021*.

PROPOZUESI

KRYETARI

Blerim Sejdiu

PROGRAM

(Për investime në vitin 2022 të parapara me buxhetin e komunës)

Për dallim nga viti paraprak shkollor 2020/2021,sivjet viti i ri shkollor 2021/2022,filloi në kohën e caktuar të paraparë sipas Kalendarit për organizimin dhe punën në shkollat fillore për vitin shkollor 2021/2022.

Risi në këtë vit shkollor është ajo se: ky vit shkollor filloi me pjesëmarrjen fizike të nxënësve në banat shkolle,por që kuptohet nën masat e rrepta të sigurisë për mbrojtje nga Pandemia e Corona virusir Covid-19,sipas Planit dhe Protokoleve për mbrojtje nga Pandemia të sjellura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e të parapara nga Komisioni shëndetsor për parandalim nga sëmundjet ngjitëse dhe OBSH-ja.

Pos masave të sigurisë për nxënësit,të punësuarit dhe të tjerë për mbrojtje nga Pandemia e Covid-19,që paraqet një problem në vete,këtë vit shkollor 2021/2022,organizimi i punës edukativo-arsimore do të bëhet sipas Konceptit të ri për arsim fillor,kjo metodologji e re e cila sjell vështirësi jo vetëm tek nxënësit por edhe tek vet arsimtarët për zbatimin e këtij koncepti,nga se duhet përshtatur formave dhe metodave të reja të punës në këtë kohë krize epidemiologjike.Sikurse vitet tjera edhe ky vit shkollor pati dhe ka vështirësi në furnizimin e nxënëse me tekste shkollore dhe materiale didaktiko-metodike dhe mjete tjera konkretizuese për zhvillimin e njësive të reja sipas konceptit të ri për Arsim fillor.

Komuna e Zhelinës në kuadër të mundësive të saja,dhe falë donacioneve nga biznismen dhe afarist lokal të vendit ia ka dalë që shkollat të furnizohen me material higjenike e dezinfektuese për objektet shkollore dhe hapësirat tjera mësimore.

Komuna e Zhelinës edhe këtë vit do të vazhdoj të ndërmerr masa dhe hapa konkret në përmirësimin e kushteve në rregullimin dhe meremetimin e infrastrukturës së objekteve shkollore,rregullimin e shtigjeve dhe trotoareve për nxënësit,fushave sportive shkollore shumëdimenzionale,instalim të nxemjeve qendrore nëpër objektet shkollore ku ndjehet nevoja për vitin 2022 etj.

Në kornizë ju paraqesim të dhënat e parashikimeve buxhetore për veprimtaritë që do të duhet të realizohen në vitin **2022**. Të dhënat e paraqitura në tabelarë janë pjesë e programës së

komunës së Zhelinës, si nevojë për përmirësimin e kushteve në arsim, respektivisht kushteve nëpër shkollat fillore për zhvillimin normal të procesit edukativo-arsimor.

Emri i shkollës	Shpenzime të parapara për vitin 2021/22	Lloji i investimit
Sh.f"Fan Noli"f.Pallaticë *Sh.f."Fan Noli"f.Pallaticë* *Sh.f"Fan Noli"f.Trebosh*	-sipas të dhënave të projektit =821.044,00 den) Sipas projektit në përpilim -Sipas te dhenave nga projekti =8.671,942.53	*Rekonstruimi i nyjeve sanitare të objektit të shkollës.* *-Projektimi i një salle sportive.* *Rikonstruim i objektit të shkollës,(kulmi,dritaret efikasiteti energjetik)*
Sh.f'Pashko Vasa"f.Grupçin	-sipas të dhënave të projektit në përpilim Vlerë= 300.000 den.	*-Projektimi i një çerdhe për fëmijë.*
Sh.f"Rametulla Ameti"f.Çiflik	-Sipas Parallogarisë së projektit. Vlerë= 1.700.000 den.	*-Rrethoja e fushës së sportit.*
Në të gjitha shkollat fillore qendrore dhe periferike të komunës së Zhelinës.(Nga buxheti i komunës dhe donacione te ndryshme) *Ngritja e shtëpisë së kulturës me karakter komunal.*	Vlera e 1 këndi të lojrave për fëmijë: =70.000.00 den. Vlera: =24.000.000.00 den.	*Ngritja e këndeve për lojra për fëmijë në të gjitha shkollat qendrore dhe periferike ku ka hapësira të mjaftueshme.(Buxheti i komunës dhe donator tjerë.* *Projekti dhe dokumentacioni teknik.*

Sh.f"Luigj Gurakuqi"f.Leshnicë e Poshtme	**-Sipas parallogarisë së projektit.** **Tot: =6.273.000.00.den** **Baza(fundamenti)=800.000.den.**	***Ndërtimi i objektit të shkollës fillore.*** ***-Komuna e Zhelinës.*** ***-MASH.***
Sh.f"Luigj Gurakuqi"f.Leshnicë e Poshtme	**-Sipas parallogarisë së projektit në pregaditje.** **Vlera=369.000.00 den.ose 6.000 euro**	***Invenrari i shkollës në Leshnicë e Poshtme***
Sh.f.Pashko Vasa"f,Cerovë	**Sipas parallogarisë së shkollës** **Vlera=400.000.00den**	***Inventarizimi i shkollës në f.Cerovë.***

Në kuadër të kësaj programe investive, Komuna e Zhelinës dhe autoritetet tjera kanë hartuar edhe projekte të tjera për përmirësimin e kushteve në arsim, në mënyrë të rregullt punohet në gjetjen e mundësive financiare për realizimin e tyre, dhe do të përkrahen të gjitha ata projekte të cilat do të gjejnë interesimin e donatorëve të jashtëm. Si projekte të cilat janë finalizuara dhe që pritet mbështetja e tyre financiare janë me sa vijon:

Sh.f."Pashko Vasa"f.Dëbërcë	**-Sipas parallogarisë së projektit në përgatitje.** **Vlerë = _____**	***-Rrethoja e oborrit të shkollës dhe mbulimi i stadiumit me rrjetë metalike.***
Sh.f."Pashko Vasa"f.Dobërcë	**-Sipas projektit në pregaditje** **Vlera=_____**	***-Rekonstruimi total i objektit shkollor (kulmi,dritaret,dhe efikasiteti energjetik)***
	-Sipas parallogarisë së	***-Projektimi i një salle***

Sh.f"Pashko Vasa"f.Grupçin	projektit në përpilimVlera: =44.000.000.00 den.	*sportive për nxënës dhe të rinj.*

Sh.f"Hasan Tahsini"f.Rogle	-Sipas parallogarisë së projektit. =2.000.000.den).	*-Rikonstruimi dhe zgjerimi I hapësirave të shkollës dhe fushës së sportit.*
Sh.f"Ibrahim Temo"f.Strimnicë	-Me Vlerë prej: Tot:=4.457.300.00 den - *Vlerat në denar*_____ -*Vlera në denar*_____	*-Rrethoja e shkollës.* -Mbulimi i hyrjes dhe daljes së shkollës -Zgjerimi i hapësirave të shkollës

Në kuadër të kësaj programe investuese dhe Planit vjetorë të Departamentit të Arsimit në komunën e Zhelinës mbi bazën e të cilës realizon detyrat e saja ditore, javore dhe kohore, është e nevojshme edhe përkrahja nga institucionet e themeluara prej saj dhe subjekteve tjera me interes për komunën dhe qytetarët.

Qëllimi i realizimit	*Shuma e paraparë*	*Koha e realizimit*
-Zbatimi i programit të INA-së në shkollat fillore komunale në komunën e Zhelinës. *-Manifestime dhe jubile të*	*360.000.00 den.*	*Sipas nevojës.*

figurave historike kombëtare (nën patronatin e komunës.)	*25.000 den.*	*Mars-Prill*
-Realizim i krosit pranverorë	*20.000 den.*	*Prill-Maj*
-Pjesëmarrje e shkollave në garat republikane.	*20.000 den.*	*Sipas nevojës.*
-Stimulim i kuadrit dhe nxënësve për rezultatet e arritura në lëmitë përkatëse në garat ndërkomunale dhe republikane.	*20.000 den.*	*Sipas nevojës.*
-Përkrahja financiare e botimeve për afirmimin e komunës) me interes për komunën dhe qytetarët e saj.	*20.000 den.*	*Maj-Qershor*
-Mbështetja financiare e organizimit të kampingut dhe adhuruesve të natyrës(Alpinistëve) të rinjë.	*25.000.den.*	*Maj-Qershor*
-Përkrahje rreth organizimit dhe realizimit të turnireve shkollore në nivel komunal.	*10.000 den.*	*Sipas nevojës.*
-Akademi solemne për figurat e shquara historike.	*10.000 den.*	*Sipas nevojës.*
-Stimulim i figurave për kontributin e dhënë në veprimtarinë e tyre në ngritjen e vetëdijes tek brezat e rinj.	*10.000 den.*	*Sipas nevojës.*
-Donacione tjera për shkollat me interes për nxënësit dhe kuadrin.	*30.000 den.*	
GJITHSEJ :	**550.000.00 den.**	

Në vazhdën e këtyre parashikimeve, në buxhetin e komunës së Zhelinës janë të parapara edhe mjete të tjera financiare për punë të kryera e që pritet së shpejti të kryhen,si rrjedhojë e aktiviteteve që pasojnë nga faza e parë e realizimit të punëve ndërtimore nga viti 2020/21.

- Për hartimin e këtij Propozim-Programi u shfrytëzuan burime nga:
- *Të dhëna mbi gjendjen fizike të shkollave fillore.*
- *Të dhënat elementare të shkollave fillore të komunës.*
- *Ndjekja permanente e veprimtarisë së shkollave fillore në nivel komunal.*
- *Kërkesave të administratës së shkollave.*

Seksioni për arsim:

Saubi Avziu,

_____.

Lazim Idrizi,

_____.

Obligimet e mbetura nga viti paraprak do të barten për vitin 2022.

Nr:08-1760/23

27.12.2021

Zhelinë

Këshilli i Komunës së Zhelinës

Kryetari

Bujar Baftijari